



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 24

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

(TM2 2025 dhe pritjet për TM3 2025)

Numër 24

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)	5
Hyrje	5
Përmbledhje.....	6
1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve	7
1.1 Standardet kreditore	7
1.2 Kushtet dhe rregullat.....	8
1.3 Kërkesa për kredi.....	9
1.4 Cilësia kreditore.....	10
2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare.....	10
2.1 Standardet kreditore	10
2.2 Kushtet dhe rregullat.....	11
2.3 Kërkesa për kredi.....	11
2.4 Cilësia kreditore.....	12
3.0 Financimi.....	13
3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara.	13
4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit.....	14
Kutia 1. Metodologjia	15
Pritjet për inflacionin	16

Shkurtesat

AKBK – Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

NVM- Ndërmarrjet e vogla të mesme

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2025, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e tretë të vitit 2025.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me dy pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet potenciale në sektorin bankar, si dhe zbrërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

Përmbledhje

Dinamika e kreditimit gjatë tremujorit të tretë u nxit si nga kërkesa ashtu dhe nga oferta kreditore, me këtë të fundit me ndikim më të lartë. Oferta kreditore u shtrëngua deri në një masë, veçanërisht për ekonomitë familjare, kurse në kuadër të ndërmarrjeve shtrëngimi ishte më i theksuar te ndërmarrjet e mëdha. Në anën tjetër, kishte kërkesë më të rritur për kreditë individuale në kuadër të ekonomive familjare dhe kreditë e NVM-ve në segmentin e ndërmarrjeve. Në tremujorin vijues, oferta kreditore pritet të jetë më e favorshme për segmentin e ndërmarrjeve, por edhe kërkesa kreditore pritet të jetë më e lartë. Për ekonomitë familjare, oferta kreditore pritet të vazhdoj të jetë më e shtrënguar, ndërsa kërkesa kreditore pritet të jetë përgjithësisht e pandryshuar.

Bazuar në rezultatet e anketës, **standardet kreditore** për ndërmarrjet u shtrënguan, veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa për NVM-të shtrëngimi ishte më i kufizuar. Faktorët kryesorë që kontribuan në këtë dinamikë ishin dinamikat e rritjes së përshpejtuar në tremujorin paraprak të kreditimit në krahasim me rritjen e depozitave, qasja në financim dhe perspektiva e tregut vendor, duke ndikuar në zvogëlimin e apetitit për rrezik. **Kushtet dhe rregullat kreditore** lëvizën në drejtime të ndryshme, por me prirje të përgjishme drejt shtrëngimit, ndikuar në veçanti nga normat e interesit. Niveli i aprovimit ka shënuar rritje, kryesisht për NVM-të, pasi që për ndërmarrjet e mëdha ka mbetur pothuajse i pandryshuar. **Kërkesa për kredi** shënoi rritje më të ngadalshme krahasuar me tremujorin paraprak për shkak të rënies së kërkesës nga ndërmarrjet e mëdha, e cila u kompensua pjesërisht nga rritja e kërkesës nga NVM-të, sidomos për kredi me maturitet afatshkurtër. Kreditë me probleme shënuan rritje këtë tremujor, kurse për tremujorin vijues pritet rritje më e ulët, përkatësisht pritet **përmirësim i cilësisë kreditore**. Për TM3 2025 pritet që standardet dhe kushtet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara, me tendencë shtrënguese te ndërmarrjet e mëdha. Kërkesa kreditore pritet të jetë më e lartë, kryesisht prej NVM-ve, ndërsa kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha më e ulët se në tremujorin paraprak.

Për ekonomitë familjare, **standardet kreditore** u shtrënguan në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë personale/konsumuese. Në kuadër të kushteve dhe rregullave të ofruara, u deklarua për shtrëngim në normën e interesit, ndërsa shtrëngim por në masë më të ulët kishte në madhësinë mesatare të kredisë, kërkesat për kolateral dhe pagesat tjera përveç normës së interesit. Niveli i aprovimit ka shënuar rritje të lehtë, ndryshe nga tremujori i kaluar ku ka shënuar rritje të lartë. **Kërkesa për kredi** shënoi rritje deri në një masë, kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi konsumuese dhe me maturitet afatshkurtër, kurse kërkesa për kredi hipotekare mbeti pothuajse e pandryshuar. Rritja e kërkesës për kredi konsumuese vlerësohet të jetë ndikuar nga shpenzimet më të larta të konsumit dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorit. **Cilësia e kredive** u përmirësua lehtësisht, kryesisht si rezultat i rënies së lehtë të kredive joperformuese në një bankë me rëndësi sistemike. Në TM3 2025, kërkesa për kredi pritet të mbetet e pandryshuar, ndërsa pritet shtrëngim marginal i standardeve kreditore për ekonomitë familjare në përgjithësi (Tabela 1).

Qasja në financim e bankave mbeti kryesisht e pandryshuar në TM2 2025, për dallim nga tremujori paraprak në të cilin u shënuar rritje. Financimi nga depozitat e ekonomive familjare ka shënuar rënie, mirëpo është kompenzuar deri në një masë nga financimi i bankave brenda grupit dhe nga depozitat e korporatave jo-financiare. Në tremujorin në vijim, pritet rritje e qasjes në financim, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare.

Për gjithë vitin 2025, bankat presin që **niveli inflacionit** të jetë 3.0 përqind, ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të këtij viti bankat presin të jetë rreth 3.1 përqind (sipas tabelës 2). Këto pritje janë në përputhje me trendin rritës të inflacionit, i cili vetëm në muajin qershor 2025 ka shënuar rritje prej 4.3 përqind.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore.

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM2 2025	TM3 2025 (pritjet)	TM2 2025	TM3 2025 (pritjet)
Ndërmarrjet	↘	→	→	↗
NVM	↘	→	↗	↗
Ndërmarrjet e mëdha	↘	↘	↘	→
Ekonomitë familjare	↘	↘	↗	→
Kredi për blerjen e shtëpive	↘	↘	→	→
Kredi konsumuese	↘	↘	↗	→

↗	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
↘	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
→	Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
↘	Shtyrësim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
↘	Shtyrësim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)


Burimi: BQK.

1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve

1.1 Standardet kreditore

Bazuar në rezultatet e anketës së bankave për TM2 2025, standardet kreditore për ndërmarrjet u shtrënguan në përgjithësi, por me efekt më të theksuar shtrëngimi për ndërmarrjet e mëdha (Grafiku 1). Për NVM-të u raportua shtrëngim i standardeve kreditore nga dy banka, njëra nga të cilat është bankë me rëndësi sistemike; kurse për ndërmarrjet e mëdha kishte shtrëngim të standardeve nga tri banka, dy prej të cilave me rëndësi sistemike.


Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan negativisht në standardet kreditore, përkatësisht shtrëngim të tyre gjatë tremujorit të dytë të vitit ishin rritja e përsheptuar e kreditimit (mbi planifikimin e tyre), qasja në gjithësej financimin e bankave si pasojë e rritjes së kostos së financimit, si pasojë e rritjes më të ngadalësuar të depozitave kundrejt rritjes së kreditimit, si dhe, perspektiva e tregut vendor. Mbështetja nga FKGK vazhdoi të mbetet kontribuues kyç pozitiv në ofertën kreditore bankare (Grafiku 2).

Grafik 2. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Për TM3 2025, standardet kreditore pritet të shtrëngohen por në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin aktual. Sipas deklaratimit të dy bankave, njëra prej të cilave me rëndësi sistemike, standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha do të shtrëngohen edhe në tremujorin e ardhshëm, por në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin aktual. Ndërkohë, për NVM-të, bankat deklaruan se do të aplikojnë standarde kreditore lehtësuese, por në nivele marginale. Faktorët ndikues në shtrëngim të standardeve kreditore pritet të jenë: toleranca më e ulët për të ndërmarrë rrezik, qasja në gjithsej financimin e bankave, dhe në nivel më të ulët, perspektiva e tregut vendor. Kurse, faktorët neutralizues, përkatësisht ata që do të ndikojnë në lehtësim të standardeve kreditore, për NVM-të në veçanti, do të jenë: mbështetja nga FKGK-ja, përmirësimi i cilësisë kreditore, pozicioni i likuiditetit dhe konkurrenca bankare.

1.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM2 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet lëvizën në të dy kahet, por duke anuar në territorin negativ - shtrëngim- si për NVM-të ashtu dhe për ndërmarrjet e mëdha (Grafiku 3). Konkretisht, për NVM-të u raportua lehtësim në pagesat tjera përveç normës së interesit nga një bankë me rëndësi sistemike, kurse shtrëngim në normën e interesit në kredi nga dy banka, njëra prej të cilave me rëndësi sistemike. Maturiteti i kredive, kërkesa për kolateral dhe madhësia mesatare e kredisë mbetën pothuajse të pandryshuara. Edhe për ndërmarrjet e mëdha, kushtet dhe rregullat u raportuan të ngjashme me ato të NVM-ve, me përjashtim të normës së interesit në kredi, e cila u raportua dukshëm më e shtrënguar krahasuar me NVM-të.

Grafik 3. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan negativisht në kushtet dhe rregullat kreditore, përkatësisht shtrëngim të tyre gjatë tremujorit të dytë të vitit, ishin pozita e rritja e përsheptuar e kreditimit, , qasja në gjithsej financimin e bankave, kufizimet në kapacitetin e bankave nxitur nga rritja më e ngadalësuar e depozitave krahasuar me kreditë, perspektiva e tregut vendor, si dhe cilësia e portoflios së kredive.

Këta faktorë kryesisht ndikuan në shtrëngim të normës së interesit në kredi, duke ndikuar edhe në zvogëlim të apetitit për të ndërmarrë rrezik. Mbështetja prej FKGK-së vazhdon të kontribuoj pozitivisht në kushtet dhe rregullat kreditore, por që u neutralizua nga zhvillimet tjera në tregun bankar.


Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të ndjekin trendin e tremujorit aktual – shtrëngues, por në nivel më të ulët. Vetëm dy banka (sistemike) kanë deklaruar që presin shtrëngim në normën e interesit në kredi, si për NVM-të edhe për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët përcaktues në shtrëngim të kushteve dhe rregullave mund të jetë qasja në financimin të bankave dhe konkurrenca (kosto) në sigurimin e financimit. Kurse, në zbutje të kushteve dhe rregullave bankare pritet të ndikojnë konkurrenca bankare dhe perspektiva e tregut vendor.

Në TM2 2025, **niveli i aprovimit të kredive** për ndërmarrjet shënoi rritje. Kreditë për NVM-të, si ato me maturitet afatshkurtër ashtu edhe ato afatgjata, u karakterizuan nga një nivel dukshëm më të lartë aprovimi krahasuar me kreditë për ndërmarrjet e mëdha, por krahasuar me tremujorin paraprak, niveli i aprovimit ishte më i ulët. *Për tremujorin vijues niveli i aprovimit pritet të ulët, kryesisht si pasojë e rënies së aprovimit të kredive për ndërmarrjet e mëdha, kurse për NVM-të parashihet rritje, por në nivel më të ulët se tremujori aktual.*

1.3 Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të anketës për TM2 2025, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet, përkundër rritjes së përgjithshme, ishte dukshëm më e ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Kjo erdhi si rezultat i rënies së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha, kurse rënia e përgjithshme u neutralizua prej rritjes së kërkesës kreditore nga NVM-të, veçanërisht për kredi me maturitet afatshkurtër. Dinamikat në kërkesën kreditore të ndërmarrjeve në TM2 2025 u ndikuan nga dy banka më rëndësi sistemike, dhe shumica e bankave më rëndësi jo-sistemike (Grafiku 4).

Grafiku 4. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan kërkesën e përgjithshme për kredi nga ndërmarrjet ishin nevoja për financimin e investimeve fikse, si dhe për inventar dhe kapital punues, të cilat u theksuan kryesisht nga bankat më rëndësi sistemike. Ndërkohë, nevoja për financimin e bashkimeve, blerjeve dhe ristrukturimit të korporatave pati efekt negativ mbi kërkesën e përgjithshme për kredi, pasi ky faktor shënoi rënie, sipas deklaramit të një banke me rëndësi sistemike (Grafik 5).

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet, ngjashëm me tremujorin paraprak, ka mbetur e pandryshuar, *dinamikë që pritet të vazhdojë edhe në TM3 2025.*

Grafik 5. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Në TM3 2025, kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë krahasuar me tremujorin aktual, deklaruar nga katër banka, prej të cilave njëra sistemike. Ngjashëm me TM2 2025, rritja do të përcaktohet nga NVM-të, kurse rënia e kërkesës nga ndërmarrjet e mëdha do të jetë në nivel më të ulët. Kërkesa kreditore prej ndërmarrjeve pritet të ndikohet në masë të madhe nga nevoja për financim të investimeve fikse dhe inventarit e kapitalit punues.

1.4 Cilësia kreditore


Bankat në përgjithësi raportuan për rritje të nivelit të kredive jo-performuese -KJP-ve. Kjo rritje u ndikua nga rezultatet e tri bankave, një prej të cilave me rëndësi sistemike. Për TM3 2025, pritet rritje e vogël e KJP-ve, e ndikuar nga deklaratimet e dy bankave me rëndësi jo-sistemike.

2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare

2.1 Standardet kreditore

Sipas rezultateve të anketës për TM2 2025, standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare u shtrënguan deri në një masë në përgjithësi (Grafiku 6). Ky zhvillim u ndikua nga dy banka me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Ndërkohë, vetëm një bankë me rëndësi jo-sistimike deklaroi lehtësim të standardeve për kreditë për blerje të shtëpive, ndërsa bankat tjera raportuan standarde kreditore kryesisht të pandryshuara gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Grafiku 6. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Faktorët që ndikuan negativisht në standardet kreditore gjatë tremujorit të dytë ishin perspektiva e tregut vendor, perspektiva e tregut të patundshmërive, qasja në gjithsej financimin e bankave

vendore, dinamika e përsheptuar e kreditimit, raportin mes kredive dhe depozitave, nxitur nga rritja më e ngadalësuar e depozitave krahasuar me kreditë (Grafiku 7).

Grafik 7. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Për TM3 2025, pritet që standardet kreditore të shtrëngohen për ekonomitë familjare në përgjithësi, mirëpo në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin e dytë. Sipas rezultateve të anketës, vetëm një bankë me rëndësi sistemike pret të ketë shtrëngim të standardeve, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive.

2.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM2 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara në kreditë e reja për ekonomitë familjare lëvizën kryesisht në kahun negativ (Grafiku 8). Tri banka me rëndësi sistemike dhe një bankë me rëndësi jo-sistemike raportuan për shtrëngim të normës së interesit si për kreditë konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Po ashtu, shtrëngim deri në një masë u deklarua në maturitet, kërkesat për kolateral dhe pagesat tjera përveç normës së interesit. Faktorët që ndikuan në shtrëngim të kushteve dhe rregullave të aplikuara ishin perspektiva e tregut vendor, perspektiva e tregut të patundshmërive, pozita e likuiditetit dhe qasja në gjithsej financimin e bankave vendore.

Grafik 8. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare pritet të mbesin të pandryshuara, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për ato konsumuese.

Niveli i aprovimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje të lehtë, për dallim nga tremujori paraprak i cili u karakterizua me rritje të lartë të nivelit të aprovimit.

2.3 Kërkesa për kredi

Kërkesa e përgjithshme kreditore nga ekonomitë familjare shënoi rritje deri në një masë, për dallim nga tremujori paraprak ku u shënua rritje e lartë (Grafiku 9). Kreditë konsumuese shënuan rritje deri në një masë, ndërsa kreditë për blerje të shtëpive u karakterizuan me kërkesë kryesisht të pandryshuar. Rrjedhimisht, sipas maturitetit, kërkesë më të lartë kishte për kreditë afatshkurtra në raport me kërkesën për kredi me maturitet afatgjatë.


Grafik 9. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK

Rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare gjatë këtij tremujori u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve të tjera për konsum dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorit (Grafiku 10). *Për TM3 2025, kërkesa pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive.*

Grafik 10. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje deri në një masë, sipas deklarimit të një banke me rëndësi sistemike. Bankat e tjera deklaruan për cilësi kryesisht të pandryshuar të aplikacioneve kreditore. *Po ashtu, pritet për tremujorin vijues janë që cilësia e aplikacioneve të mbetet kryesisht e pandryshuar.*

2.4 Cilësia kreditore


Cilësia e portfolios kreditore për ekonomitë familjare u përmirësua lehtësisht si rezultat i rënies së kredive joperformuese në një bankë me rëndësi sistemike. Me përjashtim të dy bankave që kanë peshë të ulët në kreditim, të cilat deklaruan për rritje të nivelit të kredive joperformuese, bankat tjera deklaruan nivel kryesisht të pandryshueshëm.

Cilësia e portfolios kreditorë për ekonomitë familjare pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar në tremujorin vijues të vitit 2025.

3.0 Financimi

Qasja në financim gjatë TM2 2025 në përgjithësi mbeti e pandryshuar, për dallim nga tremujori i kaluar ku kishte rritje të qasjes në financim. Financimi nga depozitat e ekonomive familjare ka shënuar rënie sipas deklaratimit të katër bankave me rendësi sistemike, ndërsa vetëm një bankë sistemike ka deklaruar për rritje deri në një masë të financimit nga ky segment. Rritje deri në një masë gjatë kësaj periudhe ka shënuar financimi brenda grupit dhe nga depozitat e korporatave, të cilat kanë kompensuar deri në një masë rënien e depozitave prej ekonomive familjare. Sipas maturitetit, rritje ka shënuar financimi afatgjatë, ndërsa ai afatshkurtër ka shënuar rënie (Grafiku 11).

Grafik 11. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në TM3 2025, pritet të ketë rritje të qasjes në financim, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare.

3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuar.

Pyetësori i anketës për TM2 2025 është plotësuar me dy pyetje shtesë, të cilat synojnë të identifikojnë faktorët e ofertës kreditorë që ndikuan në rritjen e stokut të kredive në gjysmën e parë të vitit 2025, si dhe të vlerësojnë perceptimin e bankave lidhur me ndikimin e presionit të shtuar të likuiditetit në dinamikën e aktivitetit kreditues.

Sipas deklaratimeve të bankave, në gjysmën e parë të vitit 2025, rritja e kreditimit është nxitur kryesisht nga kërkesa e lartë e bizneseve dhe ekonomive familjare, **ndërsa nga ana e ofertës kanë ndikuar kampanjat për produktet kreditorë, mbështetja nga FKKG dhe konkurrenca e shtuar ndër bankare, që ka sjellë kushte më të favorshme huadhënieje.** Stabiliteti makroekonomik ka krijuar një ambient të përshtatshëm për zgjerimin e kreditimit, ndërsa në disa raste dinamika e përshpejtuar e kreditimit në raport me planin dhe rritja e KJP-ve kanë orientuar bankat drejt një qasjeje më të kujdesshme. Ndërsa, sa i përket pyetjes mbi ndikimin e presioneve të shtuara të likuiditetit në aktivitetin kreditor, shumica e bankave raportojnë për pozicion të qëndrueshëm likuiditeti. Megjithatë, theksojnë që presioni mbi kostot e financimit dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave kanë çuar në kujdes më të madh për menaxhimin e likuiditetit, duke përfshirë diversifikimin e burimeve të financimit dhe përmirësimin e strukturës së portofolit.

Sa i përket përgjigjeve të disagreguara të bankave për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik, për standardet kreditorë si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara, ato mbetën kryesisht të pandryshuara, me tendencë të lehtë shtrënguese, veçanërisht në kushtet e ofruara për sektorin e ndërtimit. Ngjashëm me tremujorin paraprak, kërkesa kreditorë shënoi rritje nga të gjithë sektorët, me theks të veçantë për sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore, pasuar nga sektori i prodhimit, shërbimeve

dhe tregtisë. Në tremujorin vijues, standardet kreditore si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara do të mbesin të ngjashme me tremujorin aktual. Për më tepër, edhe kërkesa kreditore pritet të jetë e ngjashme me raportimet e bankave për TM2 2025, me sektorin e pasurisë së paluajtshme (banesa) e cila do të ketë kërkesë më të lartë krahasuar me sektorët tjerë ekonomik.

4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit

Sipas anketës së realizuar në korrik 2025, bankat presin që niveli i inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2025 të jetë rreth 3.1 përqind, ndërsa për gjithë vitin 2025, ato presin që inflacioni të arrijë në 3.0 përqind. Kjo përfaqëson një rritje të konsiderueshme krahasuar me nivelin prej 1.6 përqind në vitin 2024.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM2 2025	TM3 2025	2025
1	3.3%	3.4%	3.4%
2	3.6%	3.1%	3.0%
3	2.7%	2.8%	2.8%
4	3.6%	3.0%	2.3%
5	3.4%	3.7%	3.2%
6	4.3%	4.0%	4.2%
7	3.2%	3.7%	4.5%
8	3.2%	3.1%	3.2%
9	2.2%	2.8%	2.8%
10	3.8%	1.8%	1.2%
Mesatarja	3.3%	3.1%	3.0%


Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.

Figura 12 paraqet mënyrën se si bankat vlerësojnë probabilitetin për nivele të ndryshme të inflacionit. Shpërndarja e këtyre vlerësimeve tregon pasiguri të konsiderueshme, pasi nuk ka një përqendrim të qartë të parashikimeve rreth një vlere të vetme. Kjo sugjeron mungesë një dallim ndërmjet bankave për nivelin e pritshëm të inflacionit.

Pavarësisht stabilitetit të pritur të ekonomisë vendore, bankat raportojnë se pritjet për inflacionin vazhdojnë të ndikohen nga pasiguria në zhvillimet globale. Ndër faktorët kryesorë përmenden tensionet dhe konfliktet gjeopolitike ndërmjet shteteve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zinxhirët globalë të furnizimit dhe çmimet ndërkombëtare. Një tjetër faktor i rëndësishëm është rritja e kostove të energjisë, e cila pritet të ketë ndikim negativ në ecurinë e përgjithshme të inflacionit. Rritja e tarifave të energjisë për bizneset pritet të shtojë kostot e prodhimit, duke ndikuar në rritjen zingjyrore të çmimeve të produkteve të tjera.

Pritjet për inflacionin janë gjithashtu të ndërlidhura me varësinë e lartë të ekonomisë ndaj importeve, duke e bërë ekonominë vendore të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare - veçanërisht për produktet e energjisë dhe ushqimore. Për më tepër, barrierat tregtare globale dhe pezullimi i përkohshëm i disa politikave tarifore nga SHBA kanë ndihmuar në ruajtjen e njëfarë qëndrueshmërie, por rreziku nga përshkallëzimi i mëtejshëm i tyre mbetet i lartë. Në këtë kontekst, shumica e bankave presin një rritje të lehtë të inflacionit në muajt në vijim, e ndikuar kryesisht nga çmimet e energjisë dhe pasiguritë e vazhdueshme në tregjet globale. Si përfundim, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për tremujorin e dytë të vitit 2025 tregojnë rritje të dukshme të inflacionit, me normë

Grafik 12. Probabiliteti i inflacionit për TM3 2025 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

mesatare prej 3.6 përqind, krahasuar me 2.0 përqind që ishte në tremujorin paraprak. Për gjithë vitin 2025, bankat presin që niveli i inflacionit të jetë 3.0 përqind. Këto pritje janë në përputhje me trendin rritës të inflacionit, i cili vetëm në muajin qershor 2025 ka shënuar rritje prej 4.3 përqind.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuar gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuar për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen. Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga njëmbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të asetëve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar. Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pritjet për inflacionin

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndër marrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org